

**“Pak pakt”****Datat: 3, 4, 5, 6, 10, 11, 12, 13 mars**

Ora: 19:00

Komedi e zezë

Autor dhe regjisor: Ledian Gjeçi

Interpretojnë: Mehmet Xhelili, Ledjon Zoi, Erjon Hinaj, Gëzim Rudi, Ermir Hoxha, Xhuliano Brisku, Alba Shtëmbari, Margent Caushi.

**Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”**

“Pak pakt” është një vepër e re bashkëkohore, fituese e çmimit të parë në zhanrin dramaturgjik nga “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit për vitin 2021”.

Vepra bën fjalë për dy djem shqiptarë të shkolluar mirë, por thellësisht të varfër e të mbytur në borxhe, të cilët i kap policia, duke tentuar të ikin jashtë shtetit në mënyrë ilegale. Shpresa e tyre e vetme për një jetë më të mirë shkatërrohet plotësisht. Por, vjen dikush dhe iu ofron djemve një pakt me të cilin ata mund të dalin nga burgu dhe mund të përfitojnë dokumente në çdo shtet evropian, vetëm nëse deklarojnë publikisht sikur janë homoseksualë...

Ky projekt trajton dramën e ikjes së rinisë, e braktisjes së vendit për një jetë më të mirë, e cila është një problematikë e thekshme e shoqërisë tonë. Një hemorragji që s’ka të ndalur. Dhe në këtë vepër, si për ironi, kjo dramë trajtohet në mënyrë komike dhe argëtuese, deri sa...

Kjo shfaqje teatri do u flasë shqiptarëve shqip dhe qartë.

Rezervoni në 069 57 177 46

## “Tre dimra”

**Datat: 3, 4, 5, 24, 25, 26, 31 mars**

Ora: 19:00

Autor: Tena Štivičić

Regjia: Rozi Kostani

Interpretojnë: Yllka Mujo, Luiza Xhuvani, Marjeta Ljarja, Viktor Zhusti, Sokol Angjeli, Elia Zaharia, Armela Demaj, Sonila Kapidani, Xhino Musollari, Klea Konomi, Kastriot Ramollari, Klesta Shero, Ketjona Pecnikaj, Ina Morinaj, Amri Hasanlliu dhe Lindar Kaja.

Trupa e Ansambllit Tirana; Studentët e Universitetit të Arteve

As. regjisor: Elona Hyseni

Muzika: Genti Rushi


Mjeshtër vokali: Suzana Turku

Skenograf: Stjuart Reçi

Kostumograf: Frenci Gjerasi

Ndriçimi: Ergys Baki

Grimi: Marinela Halilaj



### Teatri Metropol - Qendra Kulturore Tirana

Një shfaqje që vë në optikën e kohërave figurën e gruas dhe zërin e saj. Tri periudhat historike të tranzicionit që ka kaluar apo vazhdojnë të jenë në proces popujt e rajonit tonë, si Shqipëria e Kroacia me një ngjashmëri të plotë me realitetet e tri periudhave: në 1945 me ardhjen në pushtet të komunistëve, në 1990 ardhja e një demokracie të brishtë dhe në 2011 prona akoma e pa zgjidhur dhe përpjekja për të hyrë në Europë. Këto periudha janë të vëzhguara nëpërmjet rrugëtimit të një familjeje në Zagreb të Kroacisë.

Tri net të gjata dimri, në periudha historike me ngjarje vendimtare që ndryshojnë rrjedhën logjike të këtyre personazheve, katër breza grash me ngjarje personale, sekrete që mbeten për t'u zbuluar.

Mbrëmje-natë zhvillohen ngjarjet në tri vitet - stacione biografike. Zbulimi i rrënjëve të kësaj familjeje dhe sekretet e saj na krijojnë këtë portret familjar të udhëhequr nga dashuria.

Shfaqja ka gjuhë filmike si në mënyrën e rrëfimit të historisë, po ashtu edhe në aksionin e skenave dhe diskursin e personazheve.

## FemFest

**Datat: 5, 6, 7, 8 mars**

Një festival për gruan shqiptare!

Edicioni i parë

PROGRAMI:

**“Trupi im i mirë”**

Regjia: Altin Basha

5 mars, ora 19:00

**Salla e madhe e ArTurbina**

**“Vdis duke qeshur”**

Regjia: Ilir Bokshi

6 mars, ora 19:00

**Salla e madhe e ArTurbina**

**“Burka e Medeas”**

Regjia: Ema Andrea

7 mars, ora 19:00

**Salla e madhe e ArTurbina**

**“Unë jam vetë grua”**

Regjia: Kushtrim Koliqi

7 mars, ora 20:00

**Salla e vogël e ArTurbina**

**“Rrëfimet tona”**

Regjia: Driada Dervishi

8 mars, ora 19:00

**Salla e madhe e ArTurbina**

FemFest ka për qëllim sensibilizimin e shoqërisë për të ndryshuar realitetin në të cilin po jetojmë, duke synuar që gratë dhe vajzat të gëzojnë të drejta të barabarta në çdo sferë të jetës!

FemFest do të mbledhë artiste e artistë, aktiviste e aktivistë, qytetarë, të cilët, përmes debatit, ekspozitës, shfaqjes, këngës, sfilatës, t’u japin zë problemeve që nuk fliten, zë atyre që nuk dëgjohen.

Të ardhurat e mbledhura nga biletat do të shkojnë për 4 bursa studimi për studentet më të mira të Universitetit të Arteve.

Teatri Kombëtar

ArTurbina

Çmimi: 500 lekë

Biletaria: 04 222 3022; 068 2000 650

Orari: 9:00-13:00 & 16:00 & 19:00



## “Edmond”

**Datat: 18, 19, 20 mars**

Ora: 19:00

Komedi nga Alexis Michalik  
Regjia: Indrit Çobani & Andia Xhunga  
Interpretojnë aktorët: Lulzim Zeqja, Vasjan Lami, Helidon Fino, Luli Bitri, Laert Vasili, Ilirda Bejleri, Arben Derhemi, Flaura Kureta, Myzafer Zifla, Genci Fuga, Ina Gjonçi, Besmir Bitraku, Genti Deçka

Balerinë: Aneda Lusha, Elda Matmuja, Endri Koçeku, Serena Çerpja, Stiv Osmenaj

Tel: 04 222 3022 & 068 2000 650

Biletaria: 9:00-13:00 & 16:00-19:00

Hapur nga e marta në të diel

Çmimi i biletës: 500 lekë (E premte, e shtunë, e diel)

300 lekë (E enjte)

Tarifat e reduktuara për studentët e pajisur me kartë të vlefshme studenti (subjekt i dorëzimit të fotokopjes së saj): 250 lekë (E premte, e shtunë, e diel)

Teatri Kombëtar

ArTurbina



## “E gjelbër hiri në të zezë”

Netët e leximit

**Data: 12 mars**

Ora: 19:00

Teatri Kombëtar

Online

## Leksion për Teatrin

“Lee Strasberg”

**Data: 13 mars**

Ora: 19:00

Teatri Kombëtar

Online

## “Hall me burrë, hall pa burrë”

**Datat: 5, 6 mars**

Ora: 19:00.

Regjia: Armand Bora

Interpretojnë: Gentian Zenelaj, Eglja Ceno dhe Ilirda Bejleri

Tri beqare të divorcuara, me batutat e tyre të forta mbajnë të gozhdur publikun për gati një orë. Një komedi brilante e autorit Alil Vardar, në skenën e teatrit “Petro Marko”, me regji të Armand Borës e me lojën fantastike të Gentian Zenelajt, Eglja Cenos dhe Ilirda Bejlerit.

Teatri “Petro Marko” & Qendra e Kulturës dhe Artit, Vlorë



## “Vagon”

**Datat: 4, 5 mars**

Ora: 19:00

Autor dhe regjisor: Naser Shatrolli

Interpretojnë: Neritan Liçaj, Altea Alushi

Skenograf: Mentor Berisha

Kostumografe: Laedia Hajdari

Kompozitor: Drinor Zymberi

Asistent regjisor: Anxhela Gaxhazi

Prodhimi: Teatri Magjik

Drejtor: Eni Picalli

Sinpos: Është dramë filozofike që rrugëton nëpër binarët e lidhjes së popujve të rajonit ballkanik. Shfaqja është format kontemporan, e shtruar mbi rrotat e vagonëve të zbrazur, ndërsa në domenin ideor ngacmon drejtpërdrejtë nervat e njeriut të vetmuar në rrethana tranzicioni. Drama ka dy personazhe, babë e bijë, që kërkojnë pronësinë e një vagoni! Kush do ta fitojë betejën e vagonit, do ta kuptojmë në natën finale të shfaqjes, nën interpretimin e jashtëzakonshëm nga Neritan Liçaj më shumë se aktor dhe aktorese të talentuar Altea Alushi.

Çmimi i biletës: 300 lekë

Teatri “Andon Zako Çajupi”, Korçë

Rezervo: 0699115131



## Koncert i Orkestrës Simfonike

Data: 2 mars

Ora: 19:00

Dirigjent: Levi Hammer  
 Në piano: Théo Fouchennere  
 Orkestra Simfonike e RTSH-së rikthehet në Teatrin e Operës dhe Baletit. Me një program mjaft special që përfshin Uverturën Egmont dhe Koncertin n.4 për piano dhe orkestër nga Ludëig van Beethoven, si dhe simfoninë më të bukur të gjenitit nordik, finlandezit Jean Sibelius. Të ftuar të Orkestrës janë dirigjenti Amerikan Levi Hammer, dirigjent i asociuar në Operën e Cincinnati-t (USA) dhe Komische Oper Berlin, asistent në vite i Lorin Maazel, Kurt Masur e Sir Simon Rattle .  
 Si dhe solisti në piano Théo Fouchenneret nga Franca, pianist solist, fitues i çmimit të parë në unanimitet në Konkursin e madh të Gjenezës dhe solisti i vitit në 2019 ( Victoire de la Musique). Ai ka interpretuar me shumë dirigjentë e orkestra të njohura.



## Koncert solistik

Ora: 19:00

Holli koncertor  
 Ariet më të bukura nga kompozitorët Donizetti, Puccini, Handel, Mozart, Verdi, Bellini, Piazzolla, Rossini, Jakova në një program të vetëm, interpretuar me virtuozyt nga artistët e rinj të TKOB: sopranoja Nina Muho dhe bass-i Bledar Domi, shoqëruar në piano nga Igli Rapaj.

Biletat shiten në sportelin e TKOBAP, çdo ditë nga ora 10:00 - 14:00 dhe 16:00 - 20:00. Bileta kushton 500 lekë.

- Mbajtja e maskës është e detyrueshme gjatë gjithë qëndrimit tuaj në TKOB.

**Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor**



## MetroSound - “Jehonë Arbëreshe”

**Datat: 10, 11, 12 dhe 17, 18, 19 mars**

Teatri Metropol në bashkëpunim me Tirana European Youth Capital 2022 dhe Kongresi Rinor Kombëtar prezanton projektin e ri artistik, festivalin MetroSound - “Jehonë Arbëreshe”, i cili do të sjellë për publikun muzikën, traditën, gjuhën dhe kërkime e hulumtime mbi kulturën arbëreshe.

MetroSound - “Jehonë Arbëreshe” do të zhvillohet në Teatrin Metropol - Qendra Kulture Tirana në datat 10, 11, 12 dhe 17, 18, 19 mars, ku për disa net me radhë do të organizohen takime mbi kërkime etnomuzikologjike, antropologjike, do të organizohen koncerte e takime muzikore të ndryshme, të cilat vijnë në dimensione jo vetëm të botës muzikore World Music, por shkojnë edhe përtej idesë së përkufizimit në një zhanër. Ky takim i mbështetur tërësisht mbi kulturën arbëreshe, si një homazh për kulturën muzikore arbëreshe, vjen në drejtimin artistik të pianistit, multiinstrumentistit dhe kompozitorit Robert Bisha, i cili prej vitesh jeton në Itali. A është muzika diçka e veçantë që asnjë art tjetër nuk ka mundësi ta bëjë?! Kjo është pyetja që do të na shoqërojë në këtë udhëtim muzikor.

Programin e plotë muzikor e gjeni këtu:

<http://teatrimetropol.al/event/metrosound-jehone-arbereshe/>

Info & Rezervime: 00355 67 227 0668



## “Zhizel”

**Datat: 13, 14, 15, 16 mars**

Ora: 19:00

Koreografia nga Agron Aliaj, në 30-vje-torin e premierës.

Baleti me dy akte, me muzikë të Adol-phe Adam është i ndërtuar mbi motivet e një legjende të lashtë gjermane, me koreografi të J.Perrot, J.Corralli, M.Petipa.

Edhe pse një produksion krejtësisht i ri në skenografi, kostume apo strukturë skenike, kjo vepër u realizua mbi atë ide koreografike skenash dhe kostumesh që koreografi krijoi në platformën e tij krijuese.

Shitja e biletave, në sportelin e TKOB, çdo ditë nga ora 10:00 – 14:00 dhe 16:00 deri 20:00.

- Mbjajta e maskës gjatë qëndrimit tuaj në TKOB dhe gjatë shfaqjes është detyrueshme.

**Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor**



## Festivali Ndërkombëtar i Vokalit Operistik - “Marie Kraja”

**Datat: 28, 29 dhe 30 mars**

Për të tetëmbëdhjetin vit, Tirana, Kryeqyteti European i Rinisë pret në datat 28, 29, 30 mars 2022, Festivalin Ndërkombëtar të Vokalit Operistik - “Marie Kraja”.

I hapur për këngëtarë të rinj nga e gjithë bota, nga mosha 20 deri në 34 vjeç, ky festival është kthyer në skenën që zbulon talentet që sot po bëjnë karrierë në të gjithë botën!

**Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor**



## International women's Day

**Data: 5 mars**

Ora 13:00

Për të shtatin vit, Galeria e Artit "Vilson Kilica" në qytetin e Fierit organizon ekspozitën dedikuar Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Kjo ekspozitë, e kthyer tashmë në një traditë, mbledh artiste nga e gjithë bota. Artistet e këtij edicioni solidarizohen me koleget e tyre në Ukrainë, të cilat nuk mundën të ishin të pranishme Flora Gatsenko, Kata Rudakova, Nadiia Doicheva, Olga Morozova, Oxana Grinshteyn, Yekaterina Tkalich Zhavoronkina.

**Galeria e Artit "Vilson Kilica", Fier**



## "Botimet e mësuesve korçarë ndër vite"

**Data: 7 mars**

Në kuadër të 135-vjetorit të themelimit të Shkollës së Parë Shqipe dhe *Ditës së Mësuesit*, Muzeu i Arsimit në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit "Thimi Mitko", organizon ekspozitën me titull "Botimet e mësuesve korçarë ndër vite".

**Muzeu i Arsimit, Korçë**



## “Euro Humor”

Kuratorë: Gianni Martini dhe Abaz Hado

Në Tiranë, Kryeqytetin e Europian të Rinisë në vitin 2022, organizohet ekspozita me vepra nga Fondi Europian i Karikaturës. Kemi kënaqësinë t’ju ftojme në ekspozitën “Euro Humor”, kuruar nga Gianni Martini (Itali) dhe Abaz Hado si dhe me pjesëmarrjen e artistit të famshëm Agim Sulaj. Midis artistëve nga vende të ndryshme të botës, paraqiten edhe punime të dy emrave të njohur të artit ukrainas.

**Galeria e Arteve, Tiranë- GAT**



## “Ëvetar”

Hapur për publikun në datat:

**4 mars, ora 17:30**

**5 mars, ora 09:30-14:00 / 17:30-20:30**

**6 mars, ora 09:30-14:00 / 17:30-20:30**

**7 mars, ora 09:30-14:00**

“Ëvetar”, abetarja e parë shqipe nga Naum Veqilharxhi, shkruar me një alfabet tejet të veçantë, hap rrugëtimin e çdo abetareje tjetër në historinë e formimit të gjuhësisë sonë.

“Rrugëtimi i Abetares” vjen në COD, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Bibliotekën Kombëtare, me një ekspozitë të rrallë, që shfaq për herë të parë kronologjinë e këtij rrugëtimi.

**Biblioteka e Kryeministrit, COD.**

## “I have a dream”

**Data: 8-31 mars**

Jutta Benzenberg

Përmes objektivit të fotografes Jutta Benzenberg, vjen në COD ekspozita “I have a dream”.

Në bashkëpunim me UN Women Albania, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, COD vishet me ëndrrat e të rejave nga e gjithë Shqipëria.

**COD - Center For Openness And Dialogue**



## “Le vide n’existe pas moins que les corps”

**Data: 12-26 mars**

Artist: Fabien Bouguennec

Gallery70, Tiranë

Gallery70 ka kënaqësinë të prezantojë në hapësirën e saj ndërkombëtare “Artsy”, ekspozitën e artistit francez Fabien Bouguennec. Hapja e ekspozitës në formatin -OVR (online viewing room) me 12 mars 2022 korrespondon me ditën e fillimit të Semaine de la Francophonie.

“Mbyllur në studion time, në mungesën e ekspozitave, pata mundësi ta shndërroj këtë kohë në një shesh loje për të eksperimentuar dhe për t’i dhënë një drejtim të ri veprës sime. Ideja e kësaj ekspozite është të lidhë nocionin e boshllëkut, që nuk do të thotë “asgjë” dhe entiteti i vërtetë i karaktereve të mia, që, pavarësisht mungesës së fytyrës apo trupit nuk janë “bosh”. Pasi prej kësaj mungese ne kemi një mundësi të pamatë imagjinatë. Edhe “asgjëja” është kreative”, shprehet artisti francez.

**Gallery70, Tiranë**



## “Maçoku me çizme”

**Datat: 3, 6 mars**

Ora: 10:30, 11:30

Një ndër shfaqjet klasike, pjesë e kolonës së artë do të vijë të dielën për të gjithë ju fëmijë, në skenën e *Teatrit të Kukullave* për t’ju ofruar aventurat e pafundme të maçokut me çizme.

Ju njoftojmë se biletat mund të tërhiqen vetëm pranë Teatrit. Për shkak të masave anticovid -19 kapaciteti i publikut është i reduktuar.

Çmimi i biletës: 100 lekë

**Teatri i Kukullave**



## “Djali Miliarder”

**Data: 5 mars**

Ora 10:30, 11:30

E keni menduar ndonjëherë si do të ishte nëse do të kishit 1 miliard sterlina? Njihuni me Xho Pataten, djaloshi që ka gjithçka, përveç shokëve. Ai i kërkon babait të tij që të transferohet në një shkollë publike ku askush nuk e njih dhe do mund ta mbajë sekret faktin që është një miliarder. Aty ai njihet me Bobin, shokun e tij të ri dhe aventurat fillojnë për të dy.

A do mundet Xho ta mbajë sekretin deri ne fund? A do të ketë ai më në fund një shok të vërtetë? A janë paratë gjëja më e rëndësishme?

Përgjigjet i gjeni në teatër.

Ju njoftojmë se biletat mund të tërhiqen vetëm pranë Teatrit. Për shkak të masave anticovid -19 kapaciteti i publikut është i reduktuar.

Çmimi i biletës : 100 Lekë

**Teatri i Kukullave**



## “Borëbardha”

Premierë

11 mars, ora 18:00  
12 mars, ora 10 : 30; 11 : 30  
13 mars, ora 11 : 30

QKKF

Skena e Teatrit të Kukullave

## “Tre derrkucet”

Data: 12 mars

Ora: 11 : 00

QKKF

Micro folie, Kryeministria

## “Lulet e Idës”

Data: 12 mars

Ora: 10 : 30

TKEKS për fëmijë

ArTurbina

## “Kujtojmë për të mos harruar”

Data: 10 mars

Ora: 11:00

Programi edukativ me nxënësit e shkollës “16 Shtatori”  
Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

## “Mbresa”

Data: 11 mars

Ora: 11:00

Programi edukativ me nxënësit e shkollës “16 Shtatori”.  
Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

## THE BATMAN

**Data: 3 mars**

Aksion / Krim / Dramë / Mister

175 minuta

Aktorë: Robert Pattinson, Zow Kravitz, Paul Dano, Jeffrey Wright, Peter Sarsgaard

Regjisori: Matt Reeves

## BLACKLIGHT

**Data: 10 mars**

Aksion / Triller

108 minuta

Aktorë: Liam Neeson, Aidan Quinn, Taylor John Smith, Emmy Raver-Lampman, Claire van der Boom, Yael Stone

Regjisor: Mark Williams

## TURNING RED

**Data: 10 mars**

Cineplexx

12 mars

Kinema Millenium

Animacion / Aventurw / Komedi / Familjar / Fantazi

100 minuta

Regjisori: Domee Shi

## DOG

**Data: 17 mars**

Cineplexx

Kinema Millenium

Komedi

101 minuta

Aktorë: Channing Tatum, Luke Forbes, Ethan Suplee, Jane Adams, Kevin Nash

Regjisor: Reid Carolin, Channing Tatum

## PORTRETI I PAMBARUAR

**Data: 17 mars**

Cineplexx

18 mars

Kinema Millenium

Dramë/Histori

120 minuta

Aktorë: Remo Girone, Victoria Zinny, Beatrice Aiello, Anton Koldrinaj, Marta Gastini, Alfred Trebicka, Olta Daku, Guglielmo Radoja, Raimonda Bulku

Regjisor: Namik Ajazi

## THE LOST CITY

**Data: 24 mars**

Cineplexx

Kinema Millenium

Aksion / Aventurë / Comedi

92 minuta

Aktorë: Sandra Bullock, Daniel Radcliffe, Channing Tatum, Da'Vine Joy Randolph, Oscar Nuñez

Regjisor: Aaron Nee, Adam Nee

## SONIC THE HEDGEHOG 2

**Data: 31 mars**

Cineplexx

Kinema Millenium

Animacion / Aksion / Aventurë / Komedi / Familjar / Sci-Fi

90 minuta

Aktorë: Jim Carrey, James Marsden, Tika Sumpter, Natasha Rothwell, Shemar Moore

Regjisor: Jeff Fowler

## MORBIUS

**Data: 31 mars**

Cineplexx

Kinema Millenium

Aksion / Aventurë / Dramë / Horror / Sci-Fi / Triller

120 minuta

Aktorë: Jared Leto, Adria Arjona, Jared Harris, Matt Smith, Tyrese Gibson

Regjisor: Daniël Espinosa